

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Noter TIRANE

Nr. 3134 Rep.

Nr. 3001 Kol.

Posta e takuva
a pagua



KONTRATE
PER SHIT-BLERJEN E KUOTAVE TE
TE KAPITALIT TE SHOQERISE
"Sevasti dhe Parashqevi Qiriazi" SH.P.K

Sot ne Tirane, përparr meje noterit Ardi Bezo, me date 16.11.2011, u lidh kjo Kontrate per shit-blerjen e kuotave te 50% te Kapitalit te shoqërisë "Sevasti dhe Parashqevi Qiriazi" sh.p.k,

Ndërmjet:

Z. Ardi Bezo, i biri i Ylberit i datëlindjes 30.10.1983 lindur në Tirane dhe banues në Tirane, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i panjohur prej meje, për identitetin e të cilës mora dijeni nga Leter Njoftimi me numër 024618762, më poshtë e quajtur "shiteti",

dhe

Z. Robert Dako, i biri i Aleksandrit i datëlindjes 18/10/1944, lindur në Tirane dhe banues në Tirane, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i panjohur prej meje për identitetin e të cilës mora dijeni nga Karta e Identitetit me numër 028-40-90-56, më poshtë e quajtur "bleresi";

DUKE QENE SE z. Ardi Bezo është ortak në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "Sevasti dhe Parashqevi Qiriazi", regjistruar si e tillë me NUIS: K6183000/Q, më poshtë ne qytetin e Tiranës në adresën, Universiteti Sevasti dhe Parashqevi Qiriazi, Koder Kamez, më poshtë e quajtur "shoqëria"; dhe

MEQENËSE ortaku i shoqërisë z. Ardi Bezo zoteron kuotat e 50% (pesëdhjetë përqind) te kapitalit themeltar te shoqërisë dhe, qe me ane te Vendimit te Asamblesë se Ortakeve te datës 15.11.2011 eshte vendosur transferimi i kuotave me ane te shitjes se ketyre kuotave; dhe,

MEQENËSE z. Robert Dako pranon te bleje keto kuota si pjese e kesaj kompanie, per shumën neto, (pasi te jete zbritur tatimi ne burim prej 10%) per 225 000 Euro (dyqind e njëzet e pese mijë euro), qe përbjijnë 50% (pesëdhjetë përqind) te kapitalit themeltar te

shoqërisë; dhe

DUKE QENE SE, ortaket e kësaj shoqërie kane rane dakord te mos transferojne kuota tek te tjetet. Bleresi me nenshkrimin e kesaj kontrate, terheq cdo lloj pretendimi te tij ndaj pales tjeter te bere para kesaj date dhe me pas, te dyja palet vazhdojnë bizneset respektive, pa nderhyre ne te drejtat dhe detyrimet e njeri - betrit; dhe

DUKE QENE SE "kusht" ne kuptim te kesaj kontrate, do te kuptohet pagesa totale e shumes se blerjes se kuotave nga bleresi per shitesin, e vertetuar nga transferita bankare e kryer prej blerisit ne favor te shitesit ne llogarine bankare te ketij te fundit;

Palet ne kete kontrate rane dakort me njera tjetren per transferimin e se drejtes se pronesise se kuotave te shoqerise nepermjet shitjes se tyre persa me poshtë vijon:

1. Z. Ardi Bezo me cilësinë e Shitetit te kuotave, shet perkatesisht kuotat per 50% te kapitalit te shoqerise "Sevasti&Parashqevi Qiriazi" te zotuara prej tij, nepërmjet shitjes ne shumën neto (pas zbritjes se tatimit ne burim prej 10%) per 225 000 Euro (dyqind e njëzet e pese mijë euro).
2. Z. Robert Dako ne cilesine e Bleresit te kuotave, pranon te bleje kuotat e per 50% te kapitalit te kesaj shoqerie, nepermjet blerjes ne shumën neto (pas zbritjes se tatimit ne burim prej 10%) per 225.000 Euro (dyqind e njëzet e pese mijë Euro);
3. Shitesi e garanton bleresin se kuotat qe ai zoteron ne kapitalin e shoqerise, jane te lira dhe mbi to nuk eshte vendosur asnjë barre, dhe e sigurojne blerisit se asnjë person i trete nuk ka pretendime pronesie mbi to.
4. Shitesi e garanton blerësin, per pjesen e kuotave qe perbejne pjesen prej 50% (pesëdhjetë përqind) te kapitalit te shoqerise, se nuk ka asnjë detyrim te pashlyer kundrejt te tretave, deri ne daten e nenshkrimit te kesaj marrëveshjeje.
5. Ne rast se persona te trete apo organe shteterore kerkojne detyrime te papaguara nga shoqeria, apo nga ortaku i saj, por qe lidhen me veprimtarinë e shoqerise, detyrime keto te lindura para dates se nenshkrimit te kesaj kontrate, pagimi i tyre do te behet nga Bleresi.
6. Bleresi eshte i detyruar te paguaje Shitesin per shumen e rene dakord ne pikën 2 te kesaj kontrate, me ane te transfertes bankare pas nxjerrjes se kredise bankare per kete qellim, por jo me vone se data 15.02.2012, ne llogarine bankare te shitesit prane Bankes Union Bank, ne numrini e llogarise me

2

IBAN: AL8121411106011129445650120

7. Ne rast se shlyerja e cmimit te blerjes e percaktuar ne kete kontrate nuk do po brenda dates 15.02.2012, Bleresi detyrohet te paguaje nje kamate vonese prej 1% (një përqind) per cdo dite vonese. Nese likuidimi vonohet me tepë se nje muaj, shitesit i lind e drejta te kerkajo ne rruge ligjore perfitim e shumes.

8. Bleresi behet pronar i kuotave te blera prej 50% te kapitalit, vetem pasi te kete kryer përgesën e cmimit ne llogarine bankare te shitesit duke e vërtetuar kete me mandatin perkates te vërtetuar prej Bankes. Kjo Kontrate shit-blerje hyn ne fuqi diten e nenshkrimit te saj para noterit dhe i fillon efektet sipas dispozitive te mesiperme, ndersa ndryshimi i pronesise nga data e regjistrimit ne QKR.

SHITESI

ARDI BEZO

BLERESI

ROBERT DAKO

NOTER

LULJETA KONGOLI

NOTERE